



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr.4, datë 12.01.2018**

**PËR**

**PËR SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË REGJISTRUESVE  
KUNDËR VENDIMIT NR. 25, DATË 15.12.2017 “PËR MARRJEN DISA MASAVE  
MBI SHQETËSIMET LIDHUR ME EMRAT NËN DOMAIN.AL”.**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Shqyrtimin e ankimit administrativ të Regjistruesve kundër Vendimit nr. 25, datë 15.12.2017 “Për marrjen e disa masave mbi shqetësimet lidhur me emrat nën domain .al”,

**BAZA LIGJORE:**

1. Shkronja k) e nenit 8 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
3. Rregullore nr. 02, datë 21.02.2008 për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të paraqitur nga Grupi i Punës, si më poshtë:

1. Ankim Administrativ i datës 19.12.2017 (nr. 2309Prot. i AKEP, datë 20.12.2017) i depozituar nga Regjistruerit: ShqipëriaCom sh.p.k., KemiNet sh.p.k., Webhost sh.p.k. dhe Studio DRIAR sh.p.k.,
2. Projektvendimi për shqyrtimin e ankimit të Regjistruerit kundër Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 25, datë 15.12.2017 “Për marrjen e disa masave mbi shqetësimet lidhur me emrat nën domain .al”;
3. Relacioni shoqëruar mbi projektvendimin;
4. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E FAKTIT

1. Me anë të shkresës depozituar në AKEP me nr. 2309Prot, datë 20.12.2017, Regjistruerit ShqipëriaCom sh.p.k., KemiNet sh.p.k., Webhost sh.p.k. dhe Studio DRIAR sh.p.k., të cilët kanë marrë të drejtën e regjistrimit të domain-eve në zonën .al, kanë paraqitur ankim administrativ kundër Vendimit nr. 25, datë 15.12.2017 “Për marrjen e disa masave mbi shqetësimet lidhur me emrat nën domain.al”.
2. Regjistruerit shpjegojnë se pasi janë njohur me Vendimin nr. 25, datë 15.12.2017, dhe konkluzionet e tij, paraqesin pretendimet si më poshtë:
  - i. Vendimi nr. 25, është marrë në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 44/2015, Parimi i ligjshmërisë, pikat 2 e 3 të tij, cënojnë drejtpërdrejt interesat e ligjshme të regjistruerit të Autorizuar nga AKEP. Vendimi ka dalë jashtë kushteve të përcaktuara nga rregullorja për sa i takon Domain Name Dispute resolution Policy for .al. Marrja e një mase pezullimi dhe shpallja e një periudhe “Sunrise” të dytë nisur nga rrethanat e trajtuara në vendim nuk përbën shkak të justifikuar ligjërisht.
  - ii. Vendimi nr. 25, është marrë në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 44/2015, Parimi i transparencës. Vendimi është marrë në mënyrë jo transparente, pa u konsultuar me palët e interesuara.
  - iii. Vendimi nr. 25, është marrë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 44/2015, Parimi i proporcionalitetit. Për të arritur qëllimin e tij, duhet të ishin marrë masa që cënojnë më pak të drejtat dhe interesat e ligjshme të palëve të interesuara (*regjistruerit dhe personave fizikë/juridikë*).
  - iv. Vendimi nr. 25, është marrë në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 44/2015, Parimi i përgjegjësisë. Vendimi nuk ka parashikuar kompensim për dëmet që shkaktohen nga pezullimi i veprimeve të regjistrimit, bllokimit, transferimit apo ndryshimit të domain-eve nën .al.
  - v. Vendimi nr. 25, është marrë në kundërshtim me nenin 110 të ligjit nr. 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Dokumenti nuk është konsultuar me palët e interesuara.
  - vi. Lidhur me parashikimin e një periudhe tjetër “sunrise period” pika nr. 2 e vendimit, përbën një vendimmarrje arbitrare në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9918/2008, dhe duhet të bëhej pas një procesi konsultimi me palët e interesuara. Ky proces i dytë i “sunrise” do të zhvlerësonte arritjet e deritanishme në tregun e

administrimit të domain-it. Në rregulloren e miratuar në vitin 2008, neni 5, ishte parashikuar periudha “sunrise” dhe rregullat për veprimet që do të kryheshin gjatë kësaj periudhe për regjistrimin dhe mbrojtjen e markave dhe patentave. Kjo periudhë e dytë, nuk prek vetëm AKEP, por edhe Regjistruesit e autorizuar nga AKEP bazuar në rregullat e miratuara. Bllokimi, çregjistrimi, pezullimi apo transferimi i emrave domain të regjistruar, për shkak të efekteve të periudhës së dytë “sunrise”, do të shoqërohet me kosto financiare për regjistruesit fillimisht por edhe për zotëruesit e tyre.

- vii. Vendimi nr. 25, ka parashikuar në pikën 4, ka vendosur për inspektimin e veprimtarisë së regjistruesve për të kontrolluar zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në rregulloren nr. 2, date 21.2.2008. Ndërkohë që ligji nr. 9918/2008 e ka të përcaktuar procedurën e inspektimit gjithashtu, këto rregulla janë parashikuar edhe përmes rregullores nr. 2, datë 21.2.2008 dhe rregulloren nr. 46, 27.10.2016.
3. Në përfundim, regjistrues, pretendojnë se, Këshilli Drejtues i AKEP, ka marrë një vendim në kundërshtim me:
- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
  - Ligjin nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,
  - Rregulloren nr. 2, datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të Domain-eve nën .AL dhe nëndomain-et .gov.al, mil.al., edu.al., .com.al., .org.al. dhe .net.al.” e ndryshuar.
4. Sa më lart shpjeguar, Regjistruesit: ShqipëriaCom sh.p.k., KemiNet sh.p.k., Webhost sh.p.k. dhe Studio DRIAR sh.p.k., bazuar në Ligjin nr. 44/2015, Ligjin nr. 9918/2008 dhe Rregulloren nr. 02/2008, kërkojnë nga AKEP:

Ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 25, datë 15.12.2017/2017 “Për marrjen e disa masave mbi shqetësimet lidhur me emrat nën domain.al” dhe shfuqizimin e pikave 2, 3 dhe 4 të tij.

## **II. KONSTATIMET DHE ARSYETIMI I AKEP**

5. AKEP, pasi mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga Regjistruesit: ShqipëriaCom sh.p.k., KemiNet sh.p.k., Webhost sh.p.k. dhe Studio DRIAR sh.p.k., konstaton se, ankesa është paraqitur brenda afateve dhe plotëson kushtet e pranimit të parashikuara sipas nenit 135 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave i Republikës së shqipërisë”.
6. Lidhur me sa kërkohet nga ankimuesit për ndryshimin e Vendimit nr. 25, datë 15.12.2017 dhe shfuqizimin e pikave 2, 3 dhe 4 të tij, AKEP arsyeton se:
7. Pretendimi i ankimuesve për shkeljen e parimeve të ligjshmërisë, përgjegjësisë, drejtësisë dhe paanësisë, proporcionalitetit e transparencës, sqarojmë se, AKEP në ushtrimin e veprimtarisë e tij, bazohet në objektivat rregullatorë dhe kompetencat e parashikuara në nenet 7 e 8 të ligjit nr. 9918/2008.
8. Sa i takon pretendimit për dalje jashtë parashikimeve të rregullores për pjesën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, sqarojmë se AKEP në cilësinë e organit administrativ, trajton ankimet administrative në kuadër të ezaurimit të procedurës ankimuese

administrative fillimisht, e më pas vijimin e ankimit në rrugë gjyqësore nga palët e interesuara sipas parashikimeve në K.Pr.A.

9. Lidhur me dëmet e pretenduara nga ankimuesit, për shkak të bllokimit, çregjistrimit apo transferimit të emrave të domain-eve, apo për shkak të parashikimit të një tjetër periudhe “sunrise”, sqarojmë se, Vendimi nr. 25, në pikën 3, të tij ka vendosur vetëm pezullimin e të gjitha veprimeve për t’u kryer nga AKEP dhe Regjistruesit për regjistrimin e emrave të domain-eve nën .al. përkohësisht deri në një vendim tjetër të AKEP, duke mos i dëmtuar palët e interesuara. Ky vendim nuk ka vendosur bllokim, transferim, çregjistrim të domaineve, apo ndryshim të rregullores siç pretendohet.
10. Rregullorja nr. 02/2008, në nenin 24 të saj ka parashikuar pezullimin e veprimeve, pa u kufizuar në rastet e përcaktuara, të cilat do të vlerësohen nga Autoriteti Përgjegjës (AKEP) si organ kompetent i administrimit të domain cc.TLD.al.
11. Neni 36 i kësaj rregulloreje ka parashikuar modifikimin e rregullores në rastet kur çmohet e bazuar.
12. Sa i takon procesit të inspektimit, AKEP shpjegon se, kjo është e drejtë dhe detyrim i organit rregullator i cili në çdo moment mund të kryejë kontroll për t’u siguruar mbi zbatimin e ligjit nr. 9918/2008 si dhe akteve rregullore të nxjerra në mbështetje të tij, një nga të cilat është Rregullorja nr. 02/2008.
13. Për sa i takon pretendimit mbi konsultimin të vendimit në tërësi dhe për pikën nr. 2 të tij në veçanti, për parashikimin e periudhës “sunrise”, sqarojmë se, Vendimi nr. 25, nuk ka bërë ndryshime në rregullore, këto ndryshime janë parashikuar në të ardhmen dhe do të ndjekin hapat e e parashikuara në nenin 110 të ligjit nr. 9918/2008 për konsultimin publik.  
AKEP është i detyruar që gjatë procedurës së miratimit të rregulloreve të ndjekë të gjitha parashikimet e përcaktuara nga ligji nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Konkretisht, kërkesat e përcaktuara nga neni 110 mbi këshillimin të dokumenteve rregullore me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara. Miratimi përfundimtar i rregullores do të bëhet pas konsultimit me palët e interesuara.
14. Në përfundim të argumenteve dhe shpjegimeve si më lart, AKEP, arrin në konkluzionin se, ankimi i paraqitur nga Regjistruesit: ShqipëriaCom sh.p.k., KemiNet sh.p.k., Webhost sh.p.k. dhe Studio DRIAR sh.p.k., kundër Vendimit nr. 25, atë 15.12.2017, është i pabazuar ligjërisht.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në mbështetje të shkronjës k) të nenit 8, pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

### **V E N D O S:**

1. Të refuzojë ankimin e paraqitur nga Regjistruesit me shkresën nr. 2309 Prot. i AKEP, datë 20.12.2017, “Për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 25, datë 15.12.2017/2017 dhe shfuqizimin e pikave 2, 3 dhe 4 të tij”, si të pabazuar ligjërisht.

2. Të njoftohen Regjistruarit: ShqipëriaCom sh.p.k., KemiNet sh.p.k., Webhost sh.p.k. dhe Studio DRIAR sh.p.k., për këtë Vendim.
3. Palët kanë të drejtën e ankimit të këtij Vendimi në rrugë gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Ilir ZELA**

**ANËTARË:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**